
VENDIM EKZEKUTIV NR. 2007/41

PRKOHËSISHT PEZULLON NENIN 17 TË RREGULLORES S UNMIK-UT NR. 2006/50 TË DATS 16 TETOR 2006 MBI ZGJIDHJEN E KRRESAVE LIDHUR ME PRONN E PALUAJTSHME PRIVATE, PRFSHIR PRONN BUJQSORE DHE KOMERCIALE

Në bazë të kompetencave të dhëna mua si Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) dhe në bazë të Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të datës 10 qershor 1999 dhe në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999, sipas ndryshimeve, mbi Kompetencat e Administratës së Përkohshme në Kosovë

Pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 të datës 16 tetor 2006 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale,

Duke pasur parasysh që në bazë të Nenit 17 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 të datës 16 tetor 2006 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale e cila i ishte besuar Agjencisë Kosovare të Pronës të ushtrojë kompetencat e ekzekutimit në lidhje me çdo vendim apo urdhër dëbim të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore të Kosovës të cilat akoma nuk janë ekzekutuar,

Duke pasur parasysh se implementimi dhe zbatimi i vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (HPCC) kërkon përpjekje të përbashkëta dhe unitet ndërmjet të gjitha grupeve të interesuara përfshirë Qeverinë e Kosovës dhe bashkësinë ndërkombëtare dhe duke pasë parasysh që kjo nuk është gjendja në momentin e tashëm,

Me qëllim të pezullimit të implementimit dhe zbatimit të vendimeve të Komisionit të Kërkesave Pronësore dhe Banesore (HPCC) të cilat akoma nuk janë zbatuar,

Me anë të kësaj vendoset si në vijim:

Vendim:

1. Aplikimi i Nenit 17 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 i datës 16 tetor 2006...përkohësisht pezullohet dhe, në përputhje me këtë, të gjitha veprimet për implementim të vendimeve të Komisionit të Kërkesave Pronësore dhe Banesore

2 Perkthim jozyrtar

(HPCC) pezullohen derisa qëllimi i përbashkët i domosdoshëm dhe angazhimi i të gjitha grupeve të interesuara të përfshira në proces të ri-vendoset.

2. Ky vendim do të jetë pa cenuar kompetencat e Agjencisë Kosovare të Pronës i caktuar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60 të datës 16 tetor 2006 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale të vazhdojë, sikurse iu është dhënë mandat sipas kësaj Rregullore, me proces të zgjidhjes së kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale në bazë të ligjit në fuqi.

Nënshkruar më 2 gusht 2007.

Joachim Rücker
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Perkthim jozyrtar